

Njoftim për përqendrim që i referohet fitimit të kontrollit individual nga Ndërmarrja e Telekomunikacionit „Telekom Srbija” shoqëri aksionare Beograd, Republika e Serbisë mbi SKJNET KTV, SHPK Zlatibor, Republika e Serbisë (lënda nr. 08-33 /2025)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 11.02.2025, Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës i është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilin Ndërmarrja e Telekomunikacionit "Telekom Srbija" shoqëri aksionare Beograd, me seli të regjistruar në rrugën "Takovska" numër 2, Beograd, Republika e Serbisë do të fitojë kontroll individual, përkatësisht të drejtën e pronësisë mbi një pjesë të veprimtarisë, respektivisht mbi infrastrukturën e SKJNET KTV SHPK Zlatibor, Republika e Serbisë me seli të regjistruar në rrugën dr Dragoslava Zeke Smiljaniça bb, 31215 Zlatibor, Republika e Serbisë.

-Ndërmarrja e Telekomunikacionit „Telekom Srbija” shoqëri aksionare Beograd është operator i shërbimeve dhe rrjeteve të komunikimeve elektronike, i regjistruar për telekomunikacione kabllore, dhe nga shërbimet që ofron, veçojmë shërbimet e telefonisë fikse dhe mobile, internetit dhe shërbimet multimediale në territorin e Republikës së Serbisë.

Ndërmarrja e Telekomunikacionit „Telekom Srbija” shoqëri aksionare Beograd ka një person të lidhur në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, që është: **Shoqëria për tregti dhe shërbime MTEL SHPKNJP Shkup**, selia e së cilës është e regjistruar në rrugën "Maksim Gorki" 11/1-3, Shkup, Qendër, në Republikën e Maqedonisë së Veriut, e regjistruar për veprimtarinë: telekomunikacione me tela, përkatësisht për ofrimin e shërbimeve të mëposhtme: rrjet publik radio-komunikimi, qasje brez gjerë në internet, shërbime ndër operatore, shërbime telefonike publike të disponueshme në rrjetin publik të komunikimit mobil, ritransmetim të shërbimeve programore televizive, satelit.

Shoqëria për tregti dhe shërbime MTEL SHPKNJP Shkup ka një person të lidhur në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe ai është: **Shoqëria për telekomunikacione LIKAMOBILE SHPKNJP Shkup** me seli të regjistruar në rrugën "Maksim Gorki" 11/1-3, Shkup, Qendër. Shoqëria për telekomunikacione LIKAMOBILE SHPKNJP Shkup operon në tregun e ofrimit të shërbimeve mobile të komunikimeve elektronike (shërbim me parapagesë) dhe nuk u ofron përdoruesve të saj përfundimtar shërbim mobil me kontratë. Shoqëria për telekomunikacione LIKAMOBILE SHPKNJP Shkup është operator virtual i rrjetit mobil (MVMO) në tregun maqedonas të komunikimeve elektronike dhe ofron shërbime zanore, SMS dhe internet kombëtare, ndërkombëtare dhe roaming.

SKJNET KTV, SH.P.K. Zlatibor është operator i shërbimeve dhe rrjeteve të komunikimeve elektronike, i regjistruar për ofrimin e shërbimeve të qasjes brez gjerë fikse në internet, tregu me pakicë për ofrimin e shërbimeve të shpërndarjes së përmbajtjes mediatike në territorin e Republikës së Serbisë.

SKJNET KTV, SH.P.K. Zlatibor nuk ka persona juridikë të lidhur në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, as nuk ka realizuar të ardhura në atë territor.

Tregjet që i referohen përqendrimit:

Parashtruesi i njoftimit propozon si treg relevant në përqendrimin në fjalë të jetë tregu me pakicë për ofrimin e shërbimeve të qasjes brez gjerë fikse në internet, tregu me pakicë për ofrimin e shërbimeve të shpërndarjes së përmbajtjes mediatike, duke pasur parasysht veprimtarinë e Shoqërisë së Synuar - SKJNET KTV, SHPK Zlatibor.

Bazuar në shqyrtimin paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtje dhe mendime për këtë përqendrim në Komision. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. „Shën. Kirili dhe Metodi“ nr. 54, Shkup ose me e-mail: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë në Komision brenda 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

20.02.2025

Shkup